



# UNIVERSITETI SHETËROR I TETOVËS

STATE UNIVERSITY OF TETOVA - ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

Office for International Relations, SUT Rectorate - Ilinden b.b, 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222



Education and Culture DG



## Lajmërim !!!!

Universiteti Shtetëror i Tetovës do të marrë pjesë në Pilot programin e Komisionit Evropian, në kuadër të programit ERASMUS. Ky akt i mundëson universitetit tonë të caktojë deri në 15 studentë dhe 5 nga stafi akademik për qëndrim për studime dhe hulumtime jashtë vendit. Studentët dhe stafi akademik mund të zgjedhin nga lista e universiteteve me të cilat kemi nënshkruar Memorand të mirëkuptimit për bashkëpunim. Kjo listë është e bashkangjitur me këtë lajmërim.

Për këtë qëllim, me datë 12 mars, në hotelin Stone Bridge në Shkup do të organizohet një Ditë informative. Universiteti ynë do të ofrojë transport prej USHT-së deri në hotel. Për studentët do të rezervohen 18 vende në autobus. Ju lutemi kontaktoni Qendrën për karrierë dhe shërbime studentore, në tel. 044-356-500, lokal 510 ose në [student.services@unite.edu.mk](mailto:student.services@unite.edu.mk) për t'u regjistruar dhe për të siguruar një vend në autobus. Autobusi do të niset nga Rektorati i USHT-së në ora 8:30 të mëngjesit.

Gjithashtu mund ta kontaktoni edhe z. Alexander Woods, nga Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare në tel. 044-356-524, ose në e-mailin: [alexander.woods@unite.edu.mk](mailto:alexander.woods@unite.edu.mk).

Informata plotësuese mund të gjeni në: <http://www.na.org.mk>

Procedurat për aplikim dhe kualifikimet e nevojshme do të vendosen në këtë faqe së shpejti.

**Lista e Universiteteve me të cilat USHT-ja ka nënshkruar Memorandum dhe marrëveshje për bashkëpunim**

1. Universiteti i shkencave të aplikuara, Shtutgart - Gjermani
2. Universiteti i Manhajmit - Gjermani
3. Universiteti i Mariborit - Slloveni
4. Universiteti i Mursijas – Spanjë
5. Universiteti i Mjekësisë – Grac
6. Universiteti i Gotenburgut
7. Universiteti për arkitekturë, ndërtimtari dhe gjeodezi – Bullgarija
8. Universiteti Stafordshir – Angli